



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilajeno Me Data <u>19.09.2024</u>			
Nr. i Organiut Org. Broj	Numri i Breg	Shtojca Prilajet	Vlera Vendnost
<u>01-</u>	<u>060/01-</u>		<u>1117</u>



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-IX-** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **27.09.2024 (e Premte)**, duke filluar në ora **10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të shtëpisë së kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2025-2027.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoha.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për transferin rialokimin e mjeteve buxhetore në mes programeve-nënprogrameve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.
7. Informat lidhur me raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31.12.2023.
8. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2023.

Viti, më 18.09.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË TETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.07.2024 (e Hënë) në shtëpinë e kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10:00 h. Në mbledhje morën pjesë kryetari i Komunës së Vitisë, z.Sokol Haliti, kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ali Bajrami, z.Ramadan Deliu, znj.Valentini Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, z.Basri Sylejmani, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Rem Salihu, znj.Majlinda Shabani, znj.Lindita Demelezi z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Anisë Zejnullahu, znj.Zyrafete Rama, znj.Liridona Bislimi, z.Durim Sylejmani, z.Reshat Azizi, z.Sokol Shaqiri, z.Jakup Demiri, z.Veton Ramadani, z.Reshat Azizi, z.Ekrem Ymeri, znj.Arbnora Hajredini, ndërsa mungonin znj.Marigona Avdiu, znj.Lindita Demelezi, znj.Zyrafete Rama. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive zyrtare të kryetarit, mediat elektronike. Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë. Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, materialin e keni marrë me kohë, në shkrim nuk kemi pranuar as një konfirmim të ligjshmërisë për vendimet e miratuara, mirëpo pas 15 ditësh na kanë njoftuar që janë konform ligjeve. Po presim. Një përkrahje e veçantë për të gjithë mërgimtarët që po kalojnë pushime në vendin e tyre. E kemi bërë si praktik që një kohë të gjatë, që kur e kemi informatën e kryetarit që pika parë, pyetje dhe përgjigje të heket pasi që e kemi raportin e kryetarit. Besoj që edhe sot e kemi disponimin. Këshillat për këtë seancë kemi parapa këtë rend dite:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Kuvendit Komunal.
2. Informatë (Raport) i kryetarit të komunës për periudhën janar - qershor 2024.
3. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar - qershor 2024.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2025.
6. Informat nga DKA-ja, zhvillimi i procesit edukativo-arsimor dhe përfundimi i gjysëmvetorit të dytë për vitin shkollor 2023 - 2024.

A jeni që të punojmë me këtë rend dite?

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë në emër të GR të LVV kërkoj që pika e raportit kryetarit të heket, sepse nuk e kemi diskutu në KPF edhe matrialin na ka ardhë ditën e mërkurë e nuk kemi pas ko të mjaftuar për me e analizu, sepse duhet me dal në teren me e analizu e do kohë, sepse në KPF as që kemi diskut për këtë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Inforamta e kryetarit asnjëherë nuk ka ardhë në KPF, vjen direkt te kuvendi. Asnjëherë nuk e kemi diskutu në KPF.

z.Ali Bajrami: Kjo praktikë rreth informatës së punës së kryetarit është obligim ligjor që vjen në çdo gjashëmuj dhe në fund të vitit çdo here na ka ardh pa shku në KPF, prandaj ne si grup i LDK-së e mbështesim këtë rend të dit dhe kërkojmë që të mbetet kjo pikë në rend të ditës.

znj.Majlinda Shabani: Meqenëse jemi tek raporti, e kam një pyetje se: sa kish me qenë e rrugës me e diskut raportin e punës ose informatën përderisa kryetarin e komunës nuk e kemi këtu? Andaj fillimish duhet me qe kryetari prezent e për me e diskutu raportin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë i pyeta e me tha që vjen kryetari.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kryesuesi e tha një sqarim s informata a po raporti i kryetarit vjen drejtpërdrej në kuvend. Nuk është hera e parë kjo. Është praktikë, nuk duhet me qenë pengesë kjo. E di që sekretaria ka bërë përpjekje me e qu matrialin me kohë, ndoshta në emër të sekretari mundem të kërkoj falje për këtë, por megjithatë kuptone edhe angazhimin e ekzekutives, se edhe kryesuesi përshëndeti dhe ju dëshoroj mirëseardhje bashatdhetarëve tonë, për të cilët po bëjmë përpjekje maksimale që të ofrojmë shërbime sa me të mira. Kryetari do të jetë shpejtë prezent. E kam edhe një thirrje për të gjithë mërgimtar të cilët nuk janë regjistru dhe kanë paknqësi, le të lajmrohen në zyrat tona të cilat do të japin informacione për regjistrimin e tyre. Bëj thirrje që të gjithë ata mërgimtar që nuk janë regjistru deri tani, le të regjistrohen. Pjesër parë të raportit do ta prezentoj unë e shumë shpejt do të bashkëngjitet edhe kryetari. Megjithatë do ta ketë kohër limituar ka pasu një takim jo nga ana jonë po nga ana e instituconeve të Bashkimit Evropian, ku do ta ketë një viz në ora 11 për investime që janë tu u ba tek shkolla "Kuvendi i Lezhës" dhe për këtë nuk kemi mujt me e shty takimi po deri ka ora 11 do të jetë kryetari këtu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë e qes në votim miratimin e rendit të ditës. A jeni që të miratohet ky rend i ditë? Kush është pro? 17 vota pro. Kundër 1, abstenim 4, miratohet rendi i ditës.

Pikë e parë e rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e kuvendit komunal

A keni vërejtje tek procesverbali, vetëm që është i palekturuar, do të lekturohet. Pasi që nuk ka vërejtje, kërko miratimin e procesverbal. Me votat e të gjithëve miratohet procesverbali.

Pikë të dyte të rendit të ditës kemi:

2. Informatë (Raport) i kryetarit të komunës për periudhën Janar-Qershor 2024

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sot në muajin e 7-të e kemi raportin apo informatën e kryetarit të komunës, që është bërë praktikë në respektim të ligjit dhe konform Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, që tregoj dhe kryesuesi, që kryetari i komunës përveç raporteve financiare nga ana e Drejtorisë së Financave të cilat i kemi 4 brenda vitit, që gjithëhere po e respektoj muajin në vijim për shkak të mekanizmave të OSB-së edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal, është kërku që gjithëhere në muajin vijues të dalin edhe raportet, por të del edhe informata e kryetarit. Këtë përkushtimshmeri vlenë me i falenderu edhe zyrat e kryetarit që kanë qenë të përkushtuara në dhënien e raportit dhe sistemimin të cilin e ka bërë kabineti i kryetarit së bashku me kryetarin dhe që në përmbushje të afatit ligjor, që informatën sot ta keni ju para jush dhe ta shiqoni punën e cila është kry

brenda kësaj periudhe kohore kur edhe po informojmë. Megjithatë unë informatën e kam pas në duart e mia dhe kam bërë përpjekje me kqyrë punën të cilën është bërë. Në rast se e marrim në tërësi nga aspekti vuliminoz, ndoshta ka mujtë me qenë edhe shumë më e madhe, por megjithatë konsideroj që do ta kishte hup ndoshta efektin e informatës kur përshkruhen të gjitha punët me detajizim. Unë e di se zyra që është me marrdhënie me publikun dhe Zyra e Informimit ka përgatit dhe dokumentarin, por kryetari e ka pas parasysh edhe qështjen e temeratures dhe të kohes ndoshta do të na kishte marrë shumë kohë se kan qenë të paraqiteura dhe në dokumentar punet të cilat jan kry gjatë kësaj periudhe kohore, por e mendum që në këto teperatura dhe në këto angazhime kur e permendem fillimisht që kemi dhe botën e jashtme mos të hupim kësaj radhe shumë kohë në atë drejtim, për shkak që kryetari ka pas dhe debatin me qytetar, që ka qenë i njëjti dokumentar, kanë pas rast me shiku dhe me i pa sa i përket çështjeve të investimeve kapitale, ndërsa për këto digasteret tjerë ju e keni sot informatën. Në rast se shikojmë në aspektin teknik, unë konsideoj që i permbush të gjitha konditat që sot ajo të jetë para jush dhe të debatohet, por edhe në aspektin përmbajtësor të gjitha shtyllat që duhet ti ketë një informat ajo i ka, i ka të radhitura edhe zyrat të cilat janë në perputhje me statutin e komunës që statutë ka qenë i aprovuar nga ana e kuvendit komunal. I ka të shkoqituna për çdo drejtori veç e veç punët të cilat i kryen dhe që ka një element që ju kanë përmbajt dhe duhet me ju përgëzu. E kanë nga radhitja statutare, tu fillu pre 03 drejtoritë si janë të radhitura. Aty i keni të paraqitura edhe investimet kapitale, punët të cilat janë kry dhe prandaj aq më teper e begaton këtë raport që sot i keni edhe pasqyrat financare mbi gjendjen financiare të Komunës së Vitisë. Ndoshta kryetari do të jetë ai që e thotë, por megjithatë pasi ma dhanë rastin do ta themë edhe unë. Një prej sfidave në këtë gjashtëmuor që po na paraqet për çdo ditë ndoshta dhe në vijim, përkundër përpjekjeve të kryetarit që po i bënë dhe drejtoreshes së financave është zbatuesmeria nga ana e gjykatave, kontrates kolektive, përndryshe barriera tjera në përpjekje maksimale dhe punë po arritim me i tejkalu, dhe me të vërtet Vitia sot ka vend punishte të mëdha në teren, por megjithatë unë besoj dhe shpresoj që edhe kësaj do t'i gjindet zgjidhja, se na ka shkakto probleme të mëdha në ekzekutimin e vendimeve të cilet burojnë nga kontrata kolektive. Unë nuk do ju marrë më shumë kohë, pasi që kemi kryetarin dhe egzekutivin për të gjitha pyejtet të cilat i keni apo pa kjasit lidhur me informaten koha do të jetë e juaja.

znj.Majlinda Shabani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Ne e dimë që në seancat e kuvendit komunal nga Sokol Haliti shpeshherë na thuhën gënjeshtria, trillime në secilën informatë që na vije. E në raportim të tijë besa jemi mësuar edhe me qasjen e tij arrogante e shpifëse që e bënë në kuvend komunal, ku tenton që kuvendin komunal me kthi nën komand të tijë, sepse kështu funksionon ai me 0 përgjegjshmëri dhe sinqeritet karshi qytetarëve të Komunës së Vitisë. Paran e së cilës po e zhvat çdo ditë në forma nga më të ndryshmet, andaj dhe nuk duhet me na qudit fakti që shpesh herë e humb kontrollin në sjellje dhe mënyrën e qasjes së tijë. Informatën apo raportin që e keni pru sot në kuvend konunal, realisht vetëm raport nuk mund ti thuhet, ose sjelleni siç duhet ose mos e sjellni fare, sepse realisht po na e fyeni intelegjencën përderisa analizen e investimeve kapitale e keni pru në një formë të tillë ku nuk ka të specifikum qoftë emërtime të projekteve që bëhen në lokalitet të caktuara, dhe përpos kësaj nuk e kemi të specifikume shumat që janë shpenzu për këto projekte. Unë nuk e di se si kemi me diskutu ne për këtë rapor të punës, kur e dimë që mijra e miliona euro shpenzohen për çdo vit në këto investime dhe për me ju përmbajt raportit, dhe në atë çka ju e keni cekë. Më lejoni ta citoj në fjali ku thuhet që, në këtë raport të punës që e keni sjellë, d.m.th përmes kësaj informate kryetari synon të na ofroj transparencë dhe llogaridhënie për veprime të komunës, duke u bazuar në të dhëna konkrete dhe analiza objektive, andaj pyetja ime e parë është ku është kjo transparencë. Dhe ku janë këto të dhëna dhe analiza objektive. Të dhënat unë mundem me i cekë pak më poshtë prej gjendjes faktike që e kemi tek investimet kapitale që kemi në Komunën e Vitisë. Mirëpo pyetja ime parë për ty Sokol është se, sa para ki mi shpenzu dhe sa para po donë me i keqperdor të qytetarëve të Komunës së Vitisë në eksperimete të tua dhe në anën tjetër qytetarët e Komunes së Vitisë i lënë pa ujë të pijshëm. A mundesh me na tregu se sa para tjera janë shpenzu tu ndertu dhe tu shtru rrugë asfaltime për çdo vit? Dhe a kanë

pranim teknik rrugët dhe asfaltimet që shtrohen në Komunën e Vitisë. Çka mendon shembull për pamjet e kësaj rruge Lubishtë-Beguncë, ku cilësia e këtyre punimeve është nën çdo nivel çka ka me ndodhë me këto asfaltime, kush ka me dhanë llogari. Tjetrën, rrugë e ke Viti-Sllatinë e cila për një kohë shumë të shkurt, 2 vite po themë i ka 47 pjesë të harruara. Çka ka me ndodhë me ato rrugë, a duhet me u shtruar prapë dhe me para të kujt janë shtruar ato rrugë? Pyetja ime tjetër është, sepse dua me fol pak për ndërtimin e trotuareve. E ke parë edhe trotuare që ka të shumta, kam edhe fotografi të trotuareve që janë në rrugë Viti-Ramnisht, ku gjendja e trotuarave është këshu. Dhe pyetja ime kryetar është, me çfarë ideje bënë ndërtimin e trotuareve në Komunë të Vitisë, dhe sipas teje çka nënkupton me mirëmbajtje të trotuarave. Tjetra çka dua me u fokusuar është tek drejtoritë tjera, për shkak që e kam parë që në raport të punës janë të përfshira dhe drejtoritë tjera. Dhe pyetja ime për ty kryetar është se çfarë investime tjera keni bërë në drejtoritë tjera, përpos asfaltit të zi që kemi parë, që çdo vit kemi parë vetem asfaltim. P.sh.: në shëndetësi çfarë investime keni bërë? Në arsim, dhe çka mendon për njërin nga premtimet që keni pas në arsim? Shembull, për digjitalizim të shkollave ose në bujqësi për sistemin e ujitjes në bujqësi dhe shumë projekte të tjera.

z.Sokol Haliti, kryetar i Komunës së Vitisë: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë ju kam thanë që vetëm fjalorin destruktiv nuk e duroj, për tjerat mundemi me diskutu, për punë, kualitet, dinamikë, masovitet të punëve, planifikime, raport të punës, përpjekje, neglizhenca, dobësi. Për të gjitha mundemi me diskutu pa problem. Problemi është tek tendeca e fjalorit fyes që është edhe i rëndë fjalori. Ajo pjesë është destruktive. Unë i kam thanë këshilltares edhe më heret. Një pjesë e fjalorit të cilën ti tenton me paraqit dhe me akuzu, ktheje ka vetja dhe ka ata që vërtetë po abuzojnë me 2/3 e buxhetit të taksa pagusve të Kosovës, që pjesë e saj je ti, që ti faktikisht je me 2 vende të punës e angazhume dhe është mirë atë anë me kqyrë, se ti po fletë për sistem të ujitjes, a faktikisht sistem të ujitjes për bujqësi, mirëfilli e dinë që me argumente unë kam nënshkru si kryetar komune, sistem të ujitjes për ujitjen e tokave më pjellore benutative të zones që quhet hambar i prodhimitarish bujqësore për anamorav dhe ju e keni anuluar e kanë anuluar faktikisht eproret që i kanë marrë votat si i kanë marrë faktikisht e perfaqsojnë fatkeqsisht këtë vendë më shumë bëjnë dëm dhe të arritura kryesore e kanë një projekt atë që kanë anuluar jo që kanë prurë ndersa e kundërta është që në Viti janë prurë 500 projekte prej periudhes kur është bërë ai zv.minister që e kanë anuluar ai sistemin e ujitjes i cili është nënshkru me ish ministrin Mustafa, mos harroni një gjë ka jurista këtu që unë i respektoj prej qeveris dhe kuvendit, legjitime legale është në përputhje me ligjet e Kosovës është legale nënshkrimi i kryetarit me ministern dhe cili do kryetar dhe cilido ministër jo me emer por me post që vjen mandej eka për detyr vazhdimisin dhe legalitetin me pasu prandaj ka qenë obligative projekti mu implementu, edhe unë kur kam ardhë 2014 kryetar unë e kam gjetë një bugjet të planifikum nga ish perbamja e kuvendit dhe qeveris komunale ish kryetarit të cilët e kam implementu, me dopsi me mangsi me deficite me borgje etj por unë kom vazhdu dhe kurr zani nuk ma keni në atë kuptim asnjëherë asnjë ankes nuk e kam bërë por kom vazhdu me i mbulu, 4 projekte i kam pasë të cilat kanë fillu dhe pa planifiku për 2014 dhe i kam një 2 kanalizime dhe 2 shkolla, shkollën e Sllatinës, Ballancës, kanalizimin e Tërpezës, Smirës. Dhe ju e dini mirë, ato perbamja e dinë që i kemi vazhdu, ndersa projektin që e kam nënshkru për sistem të ujitjes për fshatin Skifteraj nga lumi "Letnica" me ramje të lirë, me kanale të hapura që të angohet me lumin "morava" atje në fund të Budrikës, përfuni Cernelit siç i themi ne, i planifikum shumë mirë nga inxhiniera dhe profesionalista të cilët e dinë çka është sistemi i ujitjes, kanalet e hapura, ramja e lirë e ujit dhe shfrytëzimi i Hidro ekonomisë së bollshme që për fat e kemi pas, e kanë anuluar e ky është rezultati. Prandaj Sokol Haliti edhe qeveria e tij kanë nënshkru, por unë asnjëherë nuk i atribuoj sukseset qeverisë, unë ja atribuoj edhe kuvendit edhe zyrave, edhe shoqatave të fermerve edhe prodhisve me tradit, për digjitalizim po e nderume këshilltare ne e kemi fillu me digjitalizim nëse të kujtohet fondacioni Luxemburg Kosove kemi nënshkru. Edhe a e dini se çka na ka ndodhë, ka qenë kriteri tri palësh me e nënshkru komuna me fondacionin dhe ministria, dhe në pamundësi që ministria me na përkrah, për shkak politikës segrative që po bëjnë ndaj Vitisë edhe publikisht po them që, qeveria bënte politika segrative ndaj Vitisë. Vetëm 5000 euro ja kemi qit në

kontrata me i pagu Ministria e Arsimit. Dhe çka ka ndodhë, as ato nuk i ka pagu dhe ne jemi detyru me e bë kërkesen tjetër, dhe ata e kanë lutë Qeverinë e Luxemburgut e kanë marr përsipër, për shkak se ka qenë momerandumi tri palësh për me kry edhe digjitalizimin nëpër shkolla. Po kemi fillu jo vetem me ata po edhe me efqiencen e energjisë nëpër shkolla nuk ka kufij administrativ të punëve në gjashtëmujorin edhe vazhdojn projektet. Ka projekte afatmesme, agatgjata të cilat vazhdojnë, projektet për arsim. Sot me Bashkimin Evropian jemi te “Kuvendi i Lezhës”. Ju kam thanë një ditë, bash për shkak të transparences edhe llogaridhënies e kemi projektin në Tërpezë, në Pozharan me USAID-in, i kemi seancat degjimore për buxhet, planifikimet e grupeve të interesit etj. Po ejani sot tek shkolla e mesme, ku jam prezent edhe unë, e shihni investimin e Bashkimit Evropian, e shihni se a ka sanksione Vitia prej Bashkimit Evropian. Nuk flas unë diçka pa argumentu. Çka fals unë e argumentoj, mirëpo nuk toleroj me naj fy intelgjencën, se për me qen intelgjenc nuk do me than me qenë nxënës i dyshave e me me shit men mu tan kohën këtu me filozofi, se edhe këtë njëhere njeri e ka pas provu, po kanë shku ja kanë nxjerr deftesat e u bë doktorr shkence, po arsimtarrt e kujdestarët e klasës i ka qetu në Viti, të shkollës fillore e të mesme, që e dinë të gjithë se kush çka është dhe çfarë nota ka pas e çfar niveli. Po edhe atje edhe ketu ku ka punu vlerësimin e japin të tjerët. Unë nuk pres kurr në demokraci me ta dhanë vlerësimin të gjithë, po ta japin shumica, ajo është legale e ligjitime. Prandaj ne në përputhshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje lokale punojmë e i bëjmë raportet, debatet. Me datën 1 kemi raporti per mergaten, ku do të kemi takim me mergaten, sepse edhe ata janë tatim pagues tonë dhe do ta informojmë ne për punën 6-mujore. Tek shëndetësia dhe tek arsimi, vetem shikoj dy palestrat që i kemi nis të reja shkollore sportive ne Slltinë edhe tek shkolla mesme “Kuvedni i Lezhës” dhe shkoni vizitone kampusin e shkollave e shini sa projekte janë tu punu. Kabinetet, ka shkollë e cila e ka pas letren mu nderpre puna atje, shko keshyre kabinetin e kimisë dhe të biologjisë, është model. Natyrisht, ne punojmë edhe zgjerimin e hapësirave shkollore në Ramnishtë. Tash kemi hec me zgjerimin e hapësirave shkollore, por këto një nga një mundem t’i detajojmë. Këto janë tema që keni të drejtë me i ngrit edhe ne i paraqesim. Po e thamë që kurr kurr gjatëmujor me të suksesshëm Vitia nuk ka pas. Me volumin e punëve që është tu e bë, nuk po e thamë unë, ama kurr nuk ka pas volum me të madh të punëve. Rrugët, është e vërtetë që e mbroj konceptin tem. Unë me atë projeksion i kam fitu zgjedhjet, edhe e mbroj njëqindpërqind unë kur kam dal para qytetarëve. Ju kam thanë që ka me i lidh fshatrat nermeveti, lagjet, Vitin me komunat tjera, prandaj ju kam përmbajt me Kravaricë, në Stanqiq, me Begracë, Sllakove, ju kam përmbajt rrugës së Samakoves, po fals vetem per projektet në Lubishtë, “Rruga e Pishave”, rrugicat që jan ndreq që jan asfaltu në lagje dhe ato janë transparente, janë paraqit ne web të komunës, në debat, jane projekte gjatëmujore të ketij viti. E kemi bë dokomentarin me qenë transparent edhe pas 10 vite, ndërsa aspektet tjera teknike, pranimi, janë profesionale, janë zyrrat që e kanë përgjegjësinë. Unë më shumë se ti kërkoj të ketë ligjshmëri e llogaridhënie. Mundesh me qenë në takime edhe ti, un nuk mbaj takim pas deres, takimet e mia janë transparente, kur dush ti këshilltare mundesh me qenë prezent. Nuk ka dokument që e keni kërku ju me pas qasje që nuk ju kam nënshkru nga unë, mirëpo ty nuk të lejoj me naj fy intelgjencën, duhetsh me qenë me e përgatitur ti per me jan thy intelgjencen mu e bashkëpunëtorëve të mi. Për çështjet e ujit me keni thanë shpifës, po unë nuk jam shpifës as ma pak e as më shumë e kam mbrojt interesin e qytetarëve të Vitisë, këtë rast të fermerëve të Vitisë, projekti tepër me rëndësi. Me qenë unë kryesues i kuvedit, në momentin që i qun shpifës, gënjeshtar ti njerëzit, unë menjëhere të qes prej seancës, se ka rregullore, por ti po e shfrytëzon këtë situatë e ti përdore fjalorin derisa të lejon kryesuesi, sepse kuvendi ka rregullore, nuk lejohet me u fy njeri. Unë me qef isha kanë pjesë e këtij debati, sepse kemi punu shumë në këtë gjatëmujor. Shikoni rrugët që i kemi bë, por gjatë punës kemi edhe disa dëmtime të rrugëve. Po është formu komisioni edhe kanë me e rregullu këtë. Unë tani e kam nje takim, shkruj pyetjet për informatë e tu përgjigjem.

z. Taulant Haxhiu: Kryetar, qe dy vite asnjëhere nuk kemi pas rastin mu kanë përball me ju më shumë se 25 minuta. Respekt për aktivitetet e tua që i ki, po na kemi nevojë me i diskutu problemet e Komunës së Vitisë para njeriut të parë të komunës. Këta tjerët tut janë krejt këshilltar tu. Ti je njeri përgjegjës që

i ki marr votat për tri mandate për me e udhëheq Vitinë. Unë kam nevojë me ty me diskutu se ti mu mi zgjedh problemet e qytetarëve të Vitisë. Asnjëhere nuk kam pas rast që dy vite e gjysmë me bisedu përball teje më shumë se 12 minuta. Seancat e kuvendi komunal jan të rregullta, janë një here në muaj, na kemi nevoj me diskutu.

z.Sokol Haliti, kryetari i Komunës së Vitisë: Sa here të keni nevojë me bisedu konstruktivisht në parim për pika të rendit të ditës, sa here doni ka me qenë. Nuk muj me bisedu për 12 vite për pikën që e kemi gjashtëmujorin, nuk muj me bisedu në pikën pyetje e përgjigje, ku këtë pikë e kemi bastardu këtë pikë dhe i kemi lanë pikat e rendit të ditës që nga ekzekutiva gjithëhere ju kemi furnizu me pika të rendit të ditës. Ka komuna që nuk kanë pika të rendit të ditës e qe nuk kanë mbjat nga tre katër muaj mbledhje.

z.Taulant Haxhiu: Kryetar, në seanca të rregullta të kuvendit duhesh me qenë në seancë, sepse kemi nevojë me diskutu me ty.

z. Sokol Haliti, kryetari i Komunës së Vitisë: Nuk mundesh Kuvendin me e shndërru në muhabet të lirë jash rendit të ditës, në momentin që del jash rendit të dites.

z.Bekim Azizi, kryesusi i kuvendit: Unë e di çka jemi tu diskutu, kuvendi përher i ka trajtu çështjet që ka dashtë. Kryetar, kuvendi nuk ka deviju asnjëhere, ne e kemi trajtu çështjen para rendit të ditës ato që i ka ngritë në pyetjet dhe përgjigjet. Fjalorit duhet me ju rujt. Kryetar, ti po e shfrytëzon tu dal me gjatë, tu i ik disa temave, këto po i shfrytëzon me pyetje, po mundohuni me qenë kontret me pyetje për raportin.

z.Sokol Haliti, kryetari i Komunës së Vitisë: Unë e thash për pikën e rendit të ditës, për pyetje dhe përgjigje ka diviju e nuk thash puna e kuvendit. Nuk është më rendësi se çka thotë këshilltarja opozitare, e cila është opozitë këtu, po është në pushtet atje ku jane 2/3 të buxhetit dhe ku po i ndal projektet dhe po banë politikë segregative, po unë po tham që qet informatë gjatëmujore e paraqesim edhe un edhe ti, se është aktivitet i përbashkët dhe jemi partner.

z.Bekim Azizi, kryesusi i kuvendi: Bash barabart nuk e paraqesim, se krej çështjet i ki të kapta, nuk e paraqesim barabart, ti i ki përgjegjësitë e tua e unë të mijat, në çdo informatë e raport. I kam drejtorët e mi, qe ku janë.

z.Sokol Haliti, kryetari i Komunës së Vitisë: Drejtorët e tu nuk janë, janë të qeverisë komunale, këshilltar mi.

z.Taulant Haxhiu: Kryetar, mos ta divijojmë debatin, drejtorat jan këtu, ti pa ndihmën tonë dhe të Parti Demokratike nuk ishe sot këtu, ishe në opozitë. Kryetar i kam do pyetje tek problematika kryesor e Komunës Vitisë është ky sheshi që është ka punohet, i cili nga granti i përfomancës unë kam diskutu që ky shesh është zvar i ka zanë mërgimtarët sot këtu në Viti nuk po mujm me hi në qendër bizneset që operojnë në qender të Vitisë. N jam tu bë politikë, kanë ankesa të jashtëzakonshme, se vetëm një mërgimtar kur të vjen kur ta degjon që sun hin qendër ai kalon në presion edhe ik në Gjilan e Ferizaj. Kjo na qonë në regres te bizneset e Vitisë. Punimet janë shku shumë kadal, nuk jam kundër punimeve, as kundër shesheve, po duhet të jenë kualitative. Qyteti i Vitisë është blloku i tëri, rruga me kalldrëm askun. Kundër rrugës me kalldrëm nuk jam. A e ki pa që menjëhere kur kanë mjetet e forta aty të rana kanë fillu ato kalldrëmat me u hek. A e keni pa këtë se çfarë shtimi të kalldrëmës u bë at qyshë është rruga sot aty, shehi i kam thanë zoti Aliut që ka me na zan koha e mërgimtarëve ne deri në muajin shtat - tetor nuk mundem me e përfundu për shkak se punimet janë tu shku shumë kadal. Operatori po punon me dy 1 punëtorë në ditë, si munet me e përfundu atë shesh me këtë dinamik shumë të ngadalshme. Kur do të përfundon k rruga e sheshit? Sepse nuk kemi informata të sakta. Tek *Lindi*, prej *Lindit* deri tek *Mediterani* katër here e ke rregullu. Në atë rrugë u bë asfalti barabart me tretuar. Nuk jam kundër punimeve po nuk janë kualitative. Me u investimet që po behen në ujë, unë per 11 vjet të qeverisjes tanë 20 milion ki investu në zhavar dhe asfalt në ujë 1 mijë euro. A e din që qyteti i Vitisë ka më së shumti problem me ujë. A keni bë diçka për ujë? A kemi nevojë r

shumë për ujë a po për asfalt? A pe shehë, unë po flas si qytetar. Tek rruga e Pozharanit, prej aty deri tek pompe alidemeve, tani *Shell*, a e ki pa tretuarin çfarë trotuari është.

z.Sokol Haliti, kryetar i Komunës së Vitisë: Ti je shef i GP të PDK-së, edhe janë tu ju pa qytetarët, ti as na po e merr përgjegjësinë për punë. Unë edhe seancën e kalume kam marr pjesë në seancë. Unë punoj 24 orë në ditë 7 ditë në javë, tanë ditën punoj. Mundesh me diskutu ti me mu kur të do, qytetarët janë ata që na vlerësojnë neve juve. Punët tek *Mediterrani*, unë kam ndal dinamikën e punës për shkak të ujit, edhe tash "Hidromorava" e ka si gypin, se ajo i ka vonu procedurat. Tash ka hi gypi edhe kryhen punët.

znj.Majlinda Shabani: Nga fillimi i mandatin qasja ime ka qenë shumë konstruktive dhe e bazume argumente, mirëpo nga seanca e fundi që e kemi pas në kuvend komunal, ku kryetari i komunës vjen në mënyrë qasjes se ti, fillimisht tenton me ma ndal fjalën, mandje shpif këtu, edhe ti si kryesues e lejon një qasje të tillë, na kam se si me u sill ndaj një kryetari i cili tanë kohën gënjen dhe shpif, edhe pikërisht sot në këtë kuvend komunal diskutimin që e patëm, sepse ai ka frikë me i ballafaqu, dhe meqenëse është nënkryetari këtu, ja përcjell fjalën tërë që le të vjen në kuvend komunal dhe të ballafaqohet me diskutimin dhe debatet konstruktive deri në fund, të bazume në argumente, sepse gjithçka çka unë diskutoj janë me argumente. Kryetari vazhdimisht tenton që përmes formës ndryshme me na tregu neve këtu se si me fol, edhe me naj ndal fjalën neve, se kryetari është marakli i tenderave dhe në këtë e kemi pa, dhe i keqpërdorimit të parave publike përcdo ditë dhe nuk është në gjendje me dhanë llogari dhe me qenë transparent ndaj qytetarëve. Ai nuk e kupton se çka është transparenca dhe llogaridhënia. E kemi r kryetar i cili nuk aplikon dhe nuk shpreh gatishmërinë me qenë përfitues. E kemi rastin e fundit për banim përbalueshëm social, ku Komuna e Vitisë as nuk e ka marr mundin me u përfshi në këtë bashkëfinancim, dhe anë unë nuk mundem me e ndëgju një kryetar i cili tanë kohën mundohet me na gënju neve për punët që është ka i b edhe për paranë publike që është tu e keqpërdor. Trotualet, nënkryetar, në pasqyrat financiare tek mirëmbajtja trotuareve ki para të shpenzuara dhe në anën tjetër nëse del me e pa gjendjen e trotuareve që është në Komunën Vitisë, kur ni far mirëmbajtje nuk ka.

z.Bekim Azizi, kryesus i kuvendit: Majlindë, mos me akuzo që nuk e ke marr fjalën, se në çdo seancë e kemi marr fjalën, ke fol sa ke dashtë e çka ke dashtë ke fol. Je tu dashtë me e dominu debatin, ama asnjëhere nuk të kam ndërprerë, ama kemi edhe të tjerë që dojnë me pas fjalën.

z.Jakup Demiri: Majlinda e ka situatën për me diskutu se nga kryetari hala pa u ulë është cilësu se është hajne e grandeve të subvencioneve, e ka lëshu një grusht miza kryetari, se ka hi për me e prishë debatin edhe kete e praktikë. Kryetari edhe në raportin e gjashtëmujorit kurr nuk fol për raport, fol për projektet që i ka në imagjinë edhe pas dhjet vite kryetari iteketon, shpif, po tash heci nuk është prezent e nuk ballafaqohet, e funi i funit sa he që kemi seancë ai ka edhe punë të tjera. Nuk është në rregull kjo, ai duhet me u ballafaqu. Për me shpif ai edhe shpif unë e kam ndëgju e lexu që kryetari i Komunës së Vitisë është një prej qytetarëve që ka një vendim gati për këtë p shpifje. I vetmi qytetar në Komunën e Vitisë është kryetari i Komunës së Vitisë pikërisht për atë projektin nënshkruar në kohë të fushatës me ish kryeministrin Avdulla Hoti për ujitjen e tokës në Skifteraj, të cilin e nënshkruar me 12 shkurt e me 14 shkurt janë kanë zgjedhjet. D.m.th nuk vlen as një nënshkrim ligjërish kur je pa zgjedhjeve. Megjithatë ministria përkatëse e ka kërku projekt bire se e shtimë, nuk ka qu Komuna e Vitisë h projekt, e tani ta lidh atje me kanalizimin e Smirës, që unë e kam gjetë jo kanalizimin e Smirës, e ki vetëm fazër dyte, fazën e parë e ka kry PDK-ja, e fazën e dytë ka pas me kry LDK-ja, e i cilin kanalizim kurr nuk e ka ma pranimin teknik. Tani per ujë del e fol. Është marre sinqerisht për juve me fol, kur 24 fshatra para tri vite janë k të implementume edhe pinë ujë prej ujesjellësi, e tash pas tri vite që po deshka hanez. Çka po ndodh kjo, çka është kjo, është me rrejt qytetarin, e tek e fundit ne jemi opozitë, diskutojmë në kuvend qysh të dojmë ne, e kujt i pëlqen pëlqen e kujt si pëlqen me vjen keq. Ne e shohmi se çka po ndodh këtu pari, projekti i sheshit as nuk është i detaju:

vetëm e kanë nisur e tash nuk e dinë, para një jave nuk e kemi ditë se ku i vijnë ato pjesë tjera. Na e dimë se ne jetojmë qetu, diskutojmë edhe me inxhiniera edhe me biznese, Komuna e Vitisë gati 50% i ka gurbetqar e sot me ardhjen e këtyre gjendjeve, a sa gjysma edhe nga këta a këtyre pushim e kanë ata. Kryetari foli për palestrat sportive, për këto na kemi qarta kryetari, sidomos tek shkolla e mesme që është atje para 7-8 vite, që fëmijët nuk kanë muajt me bashkë me tash, e tash krenohet kryetari. A e din sa gjenerata kanë kaluar aty e tek e fundit për qeverisjen e mirë vitin e kaluar keni humb grandin e performancës e doni me e hup, edhe këtë e tash lenja fajin kujna të doni, e tek e fundit tendermania si shkon në Viti e dimë krejt se qetu jetojmë. Unë kam fol me herët që fillon projektin e merr, fillon kompania, drejtor shkolle vendose qekey, se neve na kallëzojnë, kemi miqasi, kemi familjar. Komuna e Vitisë na ka planifikim të investimeve, kjo dihet. Projektet, ne kur ta votojmë buxhetin pa i nda, pa i emërtu projektet, nuk ka dinamikën e punës. Kryetari hin edhe tek notat në ditar. Kjo është e rand për do familje që fëmija ju ka prejash nga shkollat në atë kohë, që nga këta kam qenë edhe unë i përjashtuar nga shkolla, edhe ata në klasën e parë, ndër dy vllëzërit e mijë edhe dy djemtë e agjes i kam pas edhe në burg. Krejt në shkollë fillore janë kanë, a ky e familja e tij e të dove kanë marr edhe beneficione në atë kohë e tash ky me këthehet në kohën e kaluar. Mos u kthe në atë kohë se është shumë e rand për do, edhe ik nga debati. Pasi që ai nuk është në sallë, nuk kam as çka me diskutu, pa që ai s'ka këtu.

z.Hasan Aliu nënkryetari i komunës: Jakup, nëse ke durimi me ndegju unë e di se shumë here edhe mu rriteni titullu, se po na mëson se si me fol. Kurr nuk kam qenë idhetar me të mesu as ty as Majlinden po vetëm janë bindur në vetveten me marr qet ingjizim të sotit edhe me e leshu pas 10 vit qaq ke me e gjyku veten ti e Majlinden për shkak të personaliteti tan se një këshilltar i kuvendit komunal nuk përdor kësi fjalori sepse nuk i bëjmë ndonjë komonës se Vitise, u thave juve drejtorave nuk ju pyet a ke najkan ti që na përcjell aty a në ras se jo ka ti këto informacion a kam të drejt me të than se është e pa vertete dhe po e dim thave se kush vjen drejtor un konsiderohej shef të grupit që ke nje pervoj politike në këtë qështje në momentin që e merr kandidaturat ti e din për afërsisht thave në rast që kthehem në të kaluarën dhe dopsia me e madhe e njeriut eshte me fol për kontributin e vete të cilin e ka dhanë un kurrë në jetën time nuk i ku këtyre qështjeve se nuk e kam bërë për Jakupin as nuk e bëj.

znj. Majlinda Shabani: Nënkyetari, po na këshillon neve se si duhet ne mu shprehë në kuvendin komunal. Unë parimisht e kam një këshillë, që me e këshillu kryetarin e juaj në formën se si duhet me hi në kuvendin komunal se sa tu hi në shpi të babës këtu, edhe nuk jemi na ata me na direktu neve se na çka me ba këtu. Diskutimi u këtu komplet në personale atë ditë në seancën e kuvendit komunal, përpos formës, mënyrën se si është shpreh kryetari komonës, fillimisht u mundu me më njolloos mua, emrin tim dhe të familjes sime, mirëpo ai e njef shumë miq familjen time se kush është, dhe unë parimisht isha me shku diskutimit deri në fund, sepse nuk mundet me më akuza mua për hajni një kryetari i cili vet është i përfshim në hajni. Kryetari e din shumë mirë prej kujt është intervistuar dinë shumë mirë edhe shkeljet që i bënë të vazhdushme dhe vjen këtu në kuvend komunal me qasje arrogante dhe me pretendin që po tenton mua me ma ndal fjalën në kuvend komunal, andaj është mirë që parimisht kjo me respektu prej të gjithëve nëse unë akozohem për mënyrën se si po shprehem në kuvend komunal, dhe në anën tjetër e ki një kryetar të Komunës së Vitisë i cili vjen në atë formë hynë në kuvend komunal edhe tenton mua përpos këtyre kur është ulë mbas mikrofinit me më thanë mu rri trus qaty mos fol. Nuk mundet me më tregu ai çka me folë, vetëm ai po askush këtu, edhe nëse mendon ai që mundet qoftë përmes formave të shantazhimit ose sulmeve të bëhen në kuvend komunal, me na ndal fjalën e ka shumë gabim. Në të del këtu përpara le të ballafaqohet rreth argumente dhe me punë që i ka bërë, por duhet me kuptu që ai është në panik dhe tash kur e kap panika atë duhet rreth u shpreh në këtë formë. Përbesë është problem, duhet me kuptu atë se i dinë punët që i ka bërë ai.

z.Basri Sylejmani: Më së pari koleges po i themë, nuk bënë se ti po e fyen kryetarin, po na fyen krejt grupin parlamentar, pa marr parasysh ne e kemi kryetar. Të lutem, vetëm gjuha pak më e butë, kurse shefit të grupit

parlamentar do të ja jap një pyetje për çështjen, lidhjen e rrugës. Nuk ka nevojë ne me dalë në protesta, po ta dir se a do të bëhet apo nuk do bëhet, se edhe një here ta kam bërë pyetjen më herët edhe tani.

z.Jakup Demiri: Projekti i cili ka qenë i ka pas defektet e veta. Kam mbajtur edhe takim para të dielës 1 javë r zv.ministrin. Më ka thanë janë evitu, është edhe një që nuk e ka formën e prer. Njëra prej parcelave private dhe a te pritja objekti që duhet për prerje nuk është parapa një projekt dhe izolimi i mirëfillt që duhet me u bë për mos r depertu kafshët dhe kjo është bërë telashe. Ka pas dhe guri tjetër, po ajo është bërë. Kompania që ka pas për me i projektet e ka pas edhe më herët tenderin, ajo ka pas obligim ne me të kemi vazhdu për me u kry më ka thanë kryeht brenda vitit. Ne jemi zotu se kemi raportin e kryetarit, pasqyrat financiare kemi dashtë me diskutu r kreytarin. Kryetari nuk është këtu, kur të vjenë kryetari ne vijmë. Unë jam tu e lëshu personalisht, kush donë me n mos ta merrë askush personale.

z.Illir Zuka: Po besoj që seanca filloj gabim, se realisht ka qenë raporti ose buxheti, diçka që është me rëndësi edhe qytetarët me ndëgju, fillimisht është dashtë me marrë shifat e grupeve fjalën, se edhe ne që jemi si pjesë ekzekutivit dhe ne kemi ankesa se kur të bëhemi me një vend që bëhen shumë punë, nuk d.m.th që bëhen krejt mi Po mënyren qysh shkoj seanca dhe që na tha neve në moment që jeni me të jeni të fyem nuk është ajo që e vlerëso janë qytetarët, më shumë se vetë kryetari i partis së saj i kallxoj vetë qka ke ba në mënyrën se si ka shku proces asaj makinerie pse po na fajson neve qka të kemi bë ne pse po na fyen neve.

z.Basri Aliu, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Një sqarim lidhur me policët e shtrirë. Pikë pari duhet me bë një kërkesë në Drejtorinë e Inspeksionit, sepse ka rregulla, ka edhe ligj që nuk lejohet çdo kund r vendos policin e shtrirë në mënyrë që me dalë inspektori i komunikacionit me vërtetu, dhe në bazë të ligjit a lejoh me u vendos polici i shtrirë.

z.Taulant Haxhiu: I nderuari drejtor, ne e bëjmë kërkesën si banor të lagjes, por ti e dinë ku është lagjja ku u banoj. Aty ka shumë banorë. Kur po e merr startin prej rrugës Pozheranit deri këtu dhe me shku në Pozheran p rruegës "Hasan Prishtina", kur të kthehesh do të rinj po vozisin 70 deri 90 orë. Ne kemi fëmij dhe kjo nuk është kërkesë e imja personale, është kërkesë e banorëve të asaj lagje. Unë e bëj një kërkesë, por besoj që nuk janë rrezikim vetëm fëmija mijë, por janë të rrezikim të gjithë banorët e asaj lagje. Është kërkesë escenciale.

z.Musli Neziri: Unë kisha dy pyetje për informatën ose raportin e kryetarit. Meqenëse qe 2 orë na maltretun kë me debate të kota, sepse nuk ja kemi borgj kërkujt, secili kemi se çka flasim, po na qesin edhe nga vetja kanjëhe. Shfrytëzoj rastin ti përshëndes të gjithë që janë prezent, mërgimtarët tanë që janë këtu në pushime e të cilët janë as për neve e për të gjithë vendin. Pyetjen e parë e kam pas rreth punimeve, rreth një ure që është tek restaurant "Yll. Atje ura është mbi lumin "Morava" ndërsa ura nuk shpie askund, kalon mbi urë anej nuk ka dalje. D.m.th këtu doshtë me ditë a jeni të informuar se si ka me pas zgjedhje në atë pjesë. Edhe pyetjen e dytë e kam pas për Drejtorinë Kadastrit. Meqenëse drejtoresha ishte në fillim, tani nuk është dashtë me pyet a është në gjendje, drejtoresha të jep një shifër se sa prona në Komunën e Vitise jan të pa identifikuara ose pa pronar, sa eshte shifra e tyre sepse sip infomratave ka shume prona a pritet që të behet zgjedha në nivel të vendit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Me sa jam me dijeni, projektin që e kemi zhvillu deri tek restaurant "Yll gjithherë është mëndu që të vazhdohet ajo te poshtë, që të jetë një shëtitore. Ajo ka shku me këtë prej urës në qend deri poshtë këtu. Tash ndoshta në shiqim të parë është e pakuptimt kur të shkojsh, por në të ardhmen e ke një proje të kryer që mund të vazhdohet dhe të jetë një shëtitore e mirë për vitiasit. Pyetjen nuk e ka të kjart për pronat pronar. Unë kam qenë drejtor në gjeodezi, nuk ka pronë pa pronar. Ndoshta të gabuar ka e ke fjalën.

z.Musli Neziri: A ka prona ose sa është shifra e pronave që janë të paindetifikuara? D.m.th a ekzistojnë parce në Komunën e Vitisë që janë pronar. Nuk qëndron askush, as komuna, as pronari fizik ose juridik. Sipas informata të mia, Komuna e Vitisë dhe Klllokotit e kanë këtë telashe.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Unë si e di nuk qëndron, por megjithatë nuk guxoj me hy, se atje qëllim është një operat kadastral, një bazë e të dhënave të cilët mund me qenë të gabume. P.sh.: prona e Taulantit me qenë emër të një serbit dhe që nuk ka historik, por e ka një emër, por në rast se ka kësi ka me të thirrë me telefon me tregu.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Faleminderit për diskutimin.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar - qershor 2024

znj.Milijate Ajeti, drejtoresha: Përshendetje për të gjithë të pranishmit. Në pika të shkurtra po ja u prezantim buxhetin komunal për periudhën janar qershor 2024. Është aprovuar nga ju asambleist, që në peridhën 3-mujore raportoj para kuvendit për shpenzim të buxhetit. Sot kemi pasqyrat financiare për 6-mujorin e parë të vitit 2024. Për këtë periudhë 6-mujore kemi pas në dispozicion buxhetin alokuar në vlerë prej 12 milion e 815 mijë e 69.21 euro janë shpenzuar 11 milion e 61 mijë e 824.46 euro, ndërsa shkalla e realizimit të buxhetit për periudhën 6-mujore krahasur me vitin e alokuar është 91%; shkalla e realizimit për këtë periudhë 6-mujore në krahasim me buxhetin vjetor të buxhetit të aprovuar është 67.71%; sipas kategorive ekonomike pagat janë shpenzuar 99.53, mallrat dhe shërbimet 87.78% dhe komunalitë 91.42%; subvencionet dhe transferet 81.91%; investime kapitale 73.01%. Që të mos ju mungoj kohë më shumë, materialin e keni marrë me kohë, për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Ali Bajrami: Drejtoreshë, faleminderit për prezantimin! Nëse ndalemi dhe i analizojmë pasqyrat financiare për janar qershor 2024, duke filluar prej Zyrës së Kryetarit dhe drejtorive, kemi të shpenzuar një buxhet në mënyrë knaqshme. Të gjitha ato obligime që dalin me Ligjin të Vetëqeverisjes Lokale janë kryer në mënyrën më të mirë mundshme ajo që më ra në sy që është një progres sa i përket investimeve kapitale duke marrë 6-mujorin e parë të vitit 2024 e kemi një përqindje shumë të mirë të shpenzimit të buxhetit shkalla e përqindjes ke 56% dmth është më shumë se 50 që jam shumë i bindur që do të vazhdon me këtë trend dhe në fund ato mjete që i kemi besoj që do të ju afrohen 100%, tek të hyrat vetanake patëm një renje të lehtë është mirë me një angazhim por besoj që tash edhe me ardhjen e mërgatës shumë të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme do të kemi një rritje është mirë që të behet një angazhim janë të hyrat që ju kthehen direkt qytetarit dhe për të mirën e qytetarit.

